



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 19235 prot.

Shkodër, më 26.09. 2025

VENDIM

Nr. 59, datë 25.09.2025

**“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 76, DATË 19.12.2024, “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2025–2027 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR.”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 25.09.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 40 dhe 41 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 20.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjit nr. 115, datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar; udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 25.06.2025 “Për një shtesë dhe ndryshimin në VKB nr. 76, datë 19.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Afatmesëm Përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër’”, i ndryshuar; si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të rishpërndarjes së fondit nga zëri i shpenzimeve operative (llog. ek. 602) te zëri i shpenzimeve kapitale të patrupezuara (llog. ek. 230) në programin AI141 Arsimi, sipas tabelës së mëposhtme:

Pakësim viti 2025

Lekë

Nr	Nr i Programit	Aktiviteti/Emërtimi	Artikulli 602 Shpenzime Operative	Institucioni likuidues
----	----------------	---------------------	-----------------------------------	------------------------

1	AI 141 Kap 5	P.AI141.Q1.O1.A22. Mirëmbajtje e zakonshme për ndërtesat e arsimit parashkollor.	336,457	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike
		Totali	336,457	

Shtesë viti 2025

Lekë

Nr	Nr i Programit	Aktiviteti/Emërtimi	Artikulli 230 Shpenzime kapitale të patrupëzuara (projekte)	Institucioni likuidues
1	AI 141 Kap 5	P.AI141.Q1.O3 .A2. Projekte Rikonstruksion i shkollave dhe fusha sporti (shtesë)	336,457	Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike
		Totali	336,457	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretaria e Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 35 vota

Vota Pro 35
Vota Kundër 1
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.09.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj


